

## VENDIM

Nr. 542, datë 27.7. 2005

### PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 4 të nenit 26 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr.153, datë 25.4.2002 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

ISTATUTI I SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

KREU I

STATUSI DHE MISIONI I SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Neni 1

Shërbimi Social Shtetëror është institucion shtetëror, me qendër në Tiranë, në vartësi të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale. Roli dhe përgjegjësitë e tij rregullohen me këtë statut.

Neni 2

Shërbimi Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionin e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin. Këtë mision e realizon nëpërmjet:

- a) inspektimit, monitorimit të standardeve të shërbimeve sociale të ofruara nga operatorët publikë, privatë dhe OJF-të në të gjithë vendin;
- b) programimit dhe detajimit të fondeve të ndihmës ekonomike;

- c) programimit dhe detajimit të fondeve të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- d) programimit dhe detajimit të fondeve për shërbimet shoqërore;
- e) kontrollit të përdorimit të fondeve buxhetore për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e shoqërore.

## KREU II

### DETYRAT E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË

#### Neni 3

##### Për shërbimet shoqërore

Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe në nivel qarku ka detyrat si vijojnë:

- a) Harton dokumentacionin tip për aplikantët dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore.
- b) Programon fondet e Buxhetit të Shtetit për shërbimet shoqërore sipas vlerësimit të nevojave nga qeverisja vendore dhe mundësive të Buxhetit të Shtetit.
- c) Detajon, që në fillim të vitit, fondet për financimin e shërbimeve shoqërore.
- d) Organizon dhe drejton procesin e inspektimit të përdorimit të fondeve të buxhetit për shërbimet shoqërore.
- e) Organizon e drejton inspektimin për zbatimin e standardeve të përgjithshme, si dhe specifike të shërbimeve shoqërore që realizojnë OJF-të dhe operatorët e tjerë publikë dhe privatë.
- f) Propozon ngritjen e shërbimeve të reja dhe përmirësimin e standardeve të shërbimeve shoqërore.
- g) Pranon dokumentacionin e subjekteve publike dhe jopublike për licencimin/rilicencimin. Vlerëson mbi bazën e dokumentacionit dhe inspektimeve, kapacitetet e aplikuesit dhe bën propozimin për licencimin e tyre në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.
- h) Propozon heqjen e licencës për subjektet që nuk plotësojnë standardet në bazë të vlerësimeve të inspektorëve të shërbimeve shoqërore.

i) Programon "Fondin shoqëror" për zbatimin e politikave dhe krijimin e shërbimeve të reja shoqërore në përputhje me nevojat e qarkut, bashkive/komunave.

j) Mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e shërbimeve shoqërore dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale. Harton raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime shoqërore dhe kapaciteteve të shërbimeve publike dhe jopublike.

k) Menaxhon institucionet e përkujdesit shoqëror me karakter kombëtar deri në fund të vitit 2007.

l) Kryen komisionimin për pranimin e personave të kategorive të ndryshme shoqërore që vendosen në institucionet publike të përkujdesit shoqëror me karakter nacional deri në fund të vitit 2007.

m) Bashkëpunon dhe koordinon punën me qarqet për funksionimin e komiteteve rajonale të planifikimit të përkujdesit komunitar për vlerësimin e nevojave dhe hartimin e planeve të përkujdesit.

n) Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet/shërbimet që ofrohen nga OJF-të dhe donatorët e huaj dhe propozon shpërndarjen e tyre në territorin e vendit.

Neni 4

Për ndihmën ekonomike

Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe në nivel qarku ka detyrat si vijojnë:

a) Harton dokumentacionin tip për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.

b) Programon fondet e Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike për çdo njësi të qeverisjes vendore në përputhje me vlerësimin e nevojave të familjeve dhe individëve në nevojë.

c) Detajon në fillim të vitit në nivel dymujor fondet e ndihmës ekonomike për çdo bashki komunë në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe të burimeve të Buxhetit të Shtetit.

d) Detajon çdo katërmujor fondet për financimin e ndihmës ekonomike në bashki/komunë për shpërndarjen e ndihmës ekonomike, që kushtëzohet me punë e shërbime në komunitet.

e) Organizon dhe drejton procesin e inspektimit të zbatimit të legjisllacionit për shpërndarjen

e fondeve të ndihmës ekonomike nga njësitë e pushtetit vendor për familjet dhe indi vidët në nevojë.

f) Mbledh dhe analizon informacionin dhe statistikat mbi shpërndarjen e ndihmës ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

#### Neni 5

Për pagesën e personave me aftësi të kufizuar

Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror dhe në nivel qarku, ka detyrat si vijojnë:

a) Harton dokumentacionin tip për aplikuesit dhe përfituesit që pretendojnë të përfitojnë nga aftësia e kufizuar.

b) Programon fondet e Buxhetit të Shtetit për pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës, për çdo njësi të qeverisjes vendore.

c) Detajon, që në fillim të vitit, si dhe çdo dy muaj, fondet për pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës për çdo bashki/komunë.

d) Organizon dhe drejton procesin e inspektimit. të shpërndarjes së fondeve nga njësitë e pushtetit vendor për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.

e) Menaxhon procesin e vlerësimit në Komisionin Mjekësor të përcaktimit të Verbërisë për përfitimin e aftësisë së kufizuar nga të verbërit në përputhje me statutin ligjor të tyre.

f) Menaxhon procesin e vlerësimit për personat me aftësi të kufizuar në Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

g) Mbledh, analizon informacionin dhe statistikat për pagesën e aftësisë së kufizuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

#### Neni 6

Për administrimin e përgjithshëm

Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror ka detyrat si vijojnë:

- a) Menaxhon burimet materiale dhe financiare të administratës qendrore e rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.
- b) Programon trajnimin e burimeve njerëzore në nivel qendror e rajonal të Shërbimit Social Shtetëror.
- c) Harton programet kualifikuese për stafet në nivel qendror e lokal dhe kurrikulat përkatëse.
- d) Harton kriteret specifike për rekrutimin e stafit në nivel qendror dhe rajonal.
- e) Drejton procesin e informimit publik, marrëdhëniet me institucionet e interesuara dhe aktorë të tjerë shoqërorë.
- f) Koordinon veprimtarinë me institucione, organizma ndërkombëtarë dhe donatorë të vendit e të huaj me interes në fushën e shërbimeve shoqërore.
- g) Vlerëson gjendjen për kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me statuset e tyre ligjore.

### KREU III

#### DREJTIMI DHE ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

##### Neni 7

Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

Organi më i lartë vendimmarrës në Shërbimin Social Shtetëror është Këshilli Administrativ. Autoriteti më i lartë ekzekutiv është Drejtori i Përgjithshëm.

##### Neni 8

Këshilli Administrativ

Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror përbëhet nga 12 anëtarë dhe 1 kryetar, i cili është Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale. Anëtarët e Këshillit janë përfaqësues në nivel zëvendësministri apo drejtor drejtorie për ministritë, në nivel drejtori për institucionet e tjera, si më poshtë:

- a) Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale
- b) Ministria e Financave
- c) Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit
- d) Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit
- e) Ministria e Shëndetësisë
- f) Shërbimi Social Shtetëror
- g) Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- h) Shërbimi Kombëtar i Punësimit
- i) Instituti i Kujdesit Shëndetësor
- j) Fakulteti i Shkencave Sociale
- k) Përfaqësues të shoqatave të personave me aftësi të kufizuar
- l) Përfaqësues të shoqatave të fëmijëve.

#### Neni 9

Emërimin nominal të anëtarëve të Këshillit Administrative bën Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, me propozim të titullarëve të institucioneve të lartpërmendura dhe OJF-ve, për një periudhë dyvjeçare.

#### Neni 10

Këshilli Administrativ miraton rregulloren e funksionimit të tij. Këshilli mbledhet jo më pak se 4 herë në vit. Mbledhjet thirren nga Kryetari i Këshillit Administrativ ose Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-it. Për pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit, anëtarët marrin shpërblim, në masën 15 mijë lekë, për çdo mbledhje.

#### Neni 11

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror kryen veprimtari ekzekutive dhe organizohet në drejtori dhe sektorë.

#### Neni 12

## Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror

Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutiv i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

### Neni 13

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për punën e tij përpara Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale. Ai emërohet dhe lirohet nga detyra nga Kryeministri me propozim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

### Neni 14

#### Kompetencat e Këshillit Administrativ

Këshilli Administrativ ka këto kompetenca:

- a) Shqyrton projektaktet ligjore dhe nënligjore, që propozohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror në zbatim të programeve të shërbimeve shoqërore.
- b) Miraton bilancin, raportin vjetor dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës.
- c) Miraton strukturën e Shërbimit Social Shtetëror, rregulloren e organizimit dhe funksionit të tij.
- d) Shqyrton në parim kontratat dhe marrëveshjet me organizatat, institucionet apo donatorë që ushtrojnë aktivitete në fushën e shërbimeve shoqërore.
- e) Shqyrton dhe miraton formimin dhe përdorimin e "Fondit shoqëror".
- f) Shqyrton studime në fushën e ndihmës ekonomike, personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- g) Propozon përmirësime në politikat dhe në legjislacionin e shërbimeve shoqërore.
- h) Miraton kurrikulat dhe programet e kualifikimit të stafëve në nivel qendror, rajonal dhe të operatorëve të tjerë publikë dhe jopublikë.

### Neni 15

## Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror ka këto kompetenca:

- a) Drejton veprimtarinë e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal.
- b) Propozon në Këshillin Administrativ, strukturën dhe organikën e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal.
- c) Propozon në Këshillin Administrativ rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.
- d) Miraton rregulloret e organizimit dhe të funksionimit të administratës së Shërbimit Social Shtetëror në nivel rajonal.
- e) Emëron dhe largon nga detyra, me miratim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, drejtorët e drejtorive në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.
- f) Emëron dhe largon nga detyra me miratim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, inspektorët e shërbimeve shoqërore dhe inspektorët e ndihmës ekonomike dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar në nivel qendror dhe në zyrat rajonale. Emëron drejtuesit dhe specialistët me arsim të lartë në strukturat e institucioneve të përkujdesit shoqëror.
- g) Miraton programe kualifikuese për stafet në nivel qendror e lokal, që nuk përfshihen në programet e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

## VENDIM

Nr.816, datë 16.11.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.542, DATË 27.7.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 4, të nenit 27 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

Në tekstin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror, që i bashkëlidhet vendimit nr.542, datë 27.7.2005 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja "a" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Administrimit të Shërbimeve Shoqërore për individët në nivel kombëtar;"

b) Në fillim të shkronjës "e", pas fjalës "Kontrollit..." shtohet shprehja "...të zbatimit të legjislationit dhe..."

c) Pas shkronjës "e" shtohen shkronjat "f" dhe "g", me përmbajtje si më poshtë vijon:

"f. Administrimit të Regjistrat Elektronik Kombëtar për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror;

g) Monitorimit të standardeve të shërbimeve sociale në nivel kombëtar".

2. Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja "d" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"d. Organizon dhe drejton procesin e monitorimit të përdorimit të fondeve të buxhetit për shërbimet shoqërore që administrojnë;"

b) Shkronja "f" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"f. Vlerëson nevojat për shërbime të reja për subjektet përfituese të shërbimeve shoqërore, sipas nenit 13 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" dhe i propozon për miratim Këshillit Administrativ ngritjen ose mbylljen e tyre në nivel kombëtar."

c) Shkronjat "g" dhe "h" shfuqizohen.

ç) Shkronjat "k" dhe "l" ndryshohen, si më poshtë vijon:

"k. Ofrimin e shërbimit rezidencial në nivel kombëtar për individët në nevojë dhe deinstitutionalizmin e shërbimeve në institucionet e përkujdesit shoqëror që administrojnë;

l. Kryen komisionimin për pranimin e personave, subjekte përfituese të shërbimeve shoqërore, sipas nenit 13 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të cilët duhet të vendosen në institucionet në nivel kombëtar për shërbimin rezidencial, si dhe për shërbimet e deinstitutionalizuara."

d) Pas shkronjës "n" shtohet shkronja "o", me këtë përmbajtje:

"o. Marrjen e vendimit për sistemin në shërbimin e përkujdesit shoqëror, pas verifikimit në regjistrin elektronik për të dhënat e hedhura nga administratorët për individët që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, ku këta të fundit nuk ofrohen nga njësia vendore."

3. Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën "c" shprehja "...në nivel dymujor..." shfuqizohet.

b) Shkronja "d" shfuqizohet.

c) Në shkronjën "e" shprehja "...inspektimit të..." shfuqizohet.

4. Në shkronjën "d" të nenit 5, shprehja "...inspektimit të..." shfuqizohet.

5. Në fund të shkronjës "d" të nenit 6, shtohet shprehja "...dhe në institucionet e përkujdesit shoqëror në nivel kombëtar."

6. Në nenin 10 fjalia e fundit shfuqizohet.

7. Në nenin 14 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja "c" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c. Propozon te ministri strukturën e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal, si dhe të institucioneve të përkujdesit shoqëror që administrojnë, i cili, sipas procedurave ligjore, e përcjell për miratim."

b) Pas shkronjës "h" shtohen shkronjat "i" dhe "j", si më poshtë vijon:

"i. Miraton rregulloret e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror.

"j. Miraton hapjen/mbylljen e shërbimeve të përkujdesit në nivel kombëtar."

8. Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja "d" ndryshohet, si më poshtë vijon:

d. Miraton rregulloret e organizimit dhe funksionimit të administratës së Shërbimit Social Shtetëror në nivel rajonal dhe të institucioneve të përkujdesit shoqëror në nivel kombëtar."

b) Shkronja "f" shfuqizohet.

c) Shkronja "g" shfuqizohet.

9. Pas nenit 16 shtohen nenet 17, 18 dhe 19, si më poshtë vijon:

"Neni 17

Rekrutimi i punonjësve

1. Punonjësit e Shërbimit Social Shtetëror emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Përzgjedhja e nëpunësve i nënshtrohet procedurave të konkurrimit të hapur.
3. Drejtori i Përgjithshëm urdhëron shpalljen e vendit të lirë në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në faqen e internetit të SHSSH-së dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së konkurrimit.
4. Kandidatët e paraqitur, krahas kërkesave të përgjithshme për t'u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", duhet të plotësojnë edhe kërkesat e veçanta të miratuara nga drejtori i përgjithshëm i SHSSH-së.
5. Procedura e testimit miratohet me akt adm inistrativ të drejtorit të përgjithshëm të SHSSH-së.
6. Drejtori i Përgjithshëm përzgjedh njërin nga dy kandidatët fitues.
7. Për emërimin dhe lirimimin e drejtuesve në drejtorinë e përgjithshme, në strukturat rajonale e vendore, si dhe të përkujdesit shoqëror që administron, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror merr miratimin paraprak të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili duhet të shprehet brenda 10 (dhjetë) ditëve.
8. Ankesat për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit i paraqiten komisionit të ngritur nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga botimi i rezultateve të konkurrimit në dy gazetatat me qarkullim më të madh.
9. Komisioni zgjidh ankesën, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e regjistrimit të ankesës, dhe vendos për:
  - a) rrëzimin e ankesës, kur nuk vëren parregullsi dhe shkelje procedurale në zhvillimin e konkurrimit;
  - b) pranimin e ankesës kur vëren parregullsi në zhvillimin e konkurrimit;
  - c) anulimin e konkurrimit, kur vëren shkelje procedurale në zhvillimin e tij.

10. Për rastet e parashikuara në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 9 të këtij neni, procedura e konkurrimit përsëritet, duke filluar nga faza ku ka pasur parregullsi procedurale.

11. Vendimi i komisionit i njoftohet të interesuarit brenda 4 (katër) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

12. Personi i interesuar mund të ankohet në gjykatën e shkallës së parë:

a) ndaj vendimit të komisionit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit;

b) brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e mbarimit të afatit për zgjidhjen e ankesës nga komisioni.

13. Marrëdhëniet juridike të punës së punonjësve të SHSSH-së, fillojnë me aktin e emërimit, i cili nënshkruhet nga drejtori i Përgjithshëm, pas përfundimit të procedurës së ankimimit, sipas pikave 9 e 10 të këtij neni.

14. Punonjësit e SHSSH-së, në momentin e punësimit të tyre, mund t'i nënshtrohen një periudhe prove, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, për të provuar aftësitë e tyre për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës.

15. Marrëdhëniet juridike të punës së punonjësve të SHSSH-së pas përfundimit të periudhës së provës, janë pa afat.

16. Procedurat e lirimit për të gjithë punonjësit e SHSSH-së rregullohet në përputhje me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

## Neni 18

### Masat disiplinore

1. Për mosplotësimin e detyrave, thyerjen e disiplinës në punë e të rregullave të etikës, si dhe për raste të tjera, të parashikuara në rregulloren e brendshme të SHSSH-së.

a) Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH-së i jepet masë disiplinore nga ministri;

b) Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së u jep masë disiplinore punonjësve të tjerë të SHSSH-së. Për drejtuesit në drejtorinë e Përgjithshme, në strukturat rajonale e vendore, si dhe ato të perkujdesit shoqëror që administrojnë, merr miratimin paraprak nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili duhet të shprehet brenda 10 (dhjetë) ditëve.

2. Masa disiplinore propozohet nga eprori direkt i punonjësit dhe jepet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, duke garantuar të drejtën për t'u informuar, dëgjuar, mbrojtur dhe ankuar.

3. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore, por nuk është e nevojshme të jepen të gjitha masat disiplinore, përpara masës së largimit nga puna.

4. Llojet e masave disiplinore janë:

a) Vërejtje me shkrim;

b) Vërejtje me paralajmërim;

c) Pezullim nga e drejta për të konkurruar për ngritje në detyrë;

ç) Largim nga puna.

5. Masat disiplinore mund të shlyhen, nëse nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore, brenda:

a) 1 (një) viti, nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" e "b" të pikës 4 të këtij neni;

b) 3 (tre) vjetësh, nga data e dhënies së tyre, për shkronjën "c" të pikës 4 të këtij neni. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake e punonjësit.

6. Ankesat ndaj vendimeve për dhënien e masave disiplinore paraqiten në komisionin e ngritur nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e komunikimit të vendimit. Drejtori i Përgjithshëm ankimohet pranë Kryeministrit.

Neni 19

Marrëdhëniet e Shërbimit Social Shtetëror me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

1. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ushtron kontroll në veprimtarinë e Shërbimit Social Shtetëror.

2. Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së raporton në strukturën politikëbërëse për çështjet e ndihmës ekonomike dhe shërbimet sociale për:

a) statusin, ecurinë e zbatimit të buxhetit, bilancin financiar, efikasitetin, rezultatet e veprimtarisë së këtij institucioni dhe programet e zbatuara apo që janë në vazhdim;

b) mbledhjen dhe përpunimin e evidencave statistikore për nivelin qendror, rajonal dhe atë vendor;

c) propozimet për përmirësime dhe ndryshi me në legjislacion, si dhe për çdo nismë për rregullore organizative dhe funksionimi, në nivel qendror e vendor, projekte, studime e bashkëpunime në fushën e ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve sociale.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror paraqet në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, propozimet për projektbuxhetin.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror paraqet brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, te Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, raportin vjetor të SHSSH-së, i cili duhet të përmbajë:

a) veprimtarinë vjetore të SHSSH-së për detyrat e përcaktuara në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) personelin e SHSSH-së;

c) statistikatat e përpunuara gjatë vitit për situatën e zbatimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore;

ç) të dhëna të tjera, që lidhen me aspektet e zbatimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore, të cilat gjykohen të nevojshme nga Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

Sali Berisha